

# SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË

## “EUROKONTAKT” SHPK TIRANË

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2020

### TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria “EUROKONTAKT” SHPK, u regjistrua si biznes në datë 20/05/2003 me administrator Z.Gjergji Kerpi, me objekt veprimtarie: Në fushën e Importit, eksportit, tregimit të pajisjeve elektronike, dixhitale, broadcast, radiotelevizive, informatike, telekomunikacionit, arkivave fizike dhe dixhitale, industriale, elektrike. Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT K31721019N

### MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2020 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”

Kontabiliteti ishoqërisë “EUROKONTAKT” SHPK, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm regjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2020 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rumbullakime.

### VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhur edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.



## SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

### AKTIVI

#### AKTIVET MONETARE

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare ne vlerën **922,174 leke**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave,përsa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera.Diferenca e likuiditeteve për vlerën **875,180** lekë, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre nëaktiv te bilancit.

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2019                      **46,994** lekë

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2020                      **922,174** lekë

---

Diferenca    **875,180 leke**

#### AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

**Kërkesa të arkëtueshme në vlerën 55,938,426 lekë** ku përfshihen detyrimet e klientëve, llogaria 411 “Kliente per mallra, produkte e sherbime” dhe **kërkesa të tjera të arkëtueshme në vlerën 2,477,475 lekë** ku përfshihet llogaria 444 “Tatimi mbi fitimin ” ; llogaria 4455 “ TVSH e zbritshme “, llogaria 4461 “Det. Per takse dog. etvsh ne dogane”.

#### INVENTARI

Inventari për vlerën **30,635,489 lekë**, përfshihet llogaria 351 “Mallra për rishitje” dhe llogaria 4091 “Paradhenie per furnizim” .

#### SHPENZIME TE SHTYRA

Shpenzime te shtyra ne vleren **33,719,500 leke** nga llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhme”, llogaria 418 “Parapagime te dhena”.

#### AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

**Aktive financiare ne vleren 904,000 leke** nga llogaria 4691 “Kinostudio huadhenie”.

**Aktive të tjera afatgjata materiale me vlerë kontabël për vlerën 152,806,173 lekë**, ku përfshihen : llogaria 215 “ Mjete transporti”, llogaria 2815 “Per mjete transporti” , llogaria 2182 “ Pajisje informative”, llogaria 2188 “Te tjera”, llogaria 2813 “ Per instalime teknike, makinerite, pajisje” , 2134 “Makineri , pajisje pune”, llogaria

2818 "Per te tjera AA materiale", llogaria 2181 "Mobilje dhe pajisje zyre", llogaria 2121 "ndertesa industriale" etj.

## PASIVI

### HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2020 detyrimet në total janë në vlerën **271,500,985 lekë** që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

**Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale 237,460,685 lekë**, ku përfshihen:

**Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit**, llogaria 401 " Llogari të pagueshme" në vlerën **72,127,006 lekë**.

**Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore** në vlerën **497,365 lekë**, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" dhe llogaria 431 "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore".

**Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën 139,371 lekë**, ku përfshihet llogaria 442 "Tatim mbi të ardhurat personale", llogaria 449 "Tatimi në burim".

**Te tjera të pagueshme në vlerën 164,607,425 leke nga llogaria 455 "Te drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve"** dhe llogaria 467 "Debitore të tjere, kreditore të tjere".

**Arketime në avance në vlerën 89,517 leke** nga parapagime të marra.

**Detyrime afatgjata në vlerën 37,058,277 leke** ku përfshihet huamarrjet në Raiffesen Bank dhe Porsche Leasing.

## KAPITALI

Gjendja e llogarive të Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën 5,902,252 leke dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar për 10,000,000 lekë, nga Humbja e mbartur (7,155,815) lekë dhe Futimi i vitit ushtrimor 2020, marrë nga PASHI, me vlerë 1,969,498 lekë.

### PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2020 Shoqëria "EUROKONTAKT" SHPK ka realizuar shpenzime në masën **44,173,418 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

**Mallra lëndet e para dhe shërbime 20,866,028 lekë** ku përfshihen llogaria 605 "Blerje /shpenz të mallrash", llogaria 6035 "Ndrysh. Gjend.mallra".

  
**EUROKONTAKT**  
IMPORT-LIAISON

**Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit 9,839,958 lekë** ku përfshihen: llogaria 604 "Bl.energji, avull,uje",llogaria 611 "Trajtime te pergjithshme", llogaria 618 "Të tjera" llogaria 626 "Shpz.postare e telekom" ,llogaria 638 "Tatime te tjera", llogaria 657 "Gjoha dhe dëmshpërblime"dhe llog 658 "Shpenzime të tjera", llogaria " 616 " Sigurime", 6271 "Transporte per blerje" , llogaria 615 "Mirembajtje dhe riparime", llogaria 634 "Taksa dhe tarifa vendore" etj

**Paga në vlerën 9,871,269 lekë** ku perfshihet 641 "Pagat dhe shpërblimet e personelit"

**Shpenzimet e sigurimeve shoqërore për 1,201,290 lekë** ku përfshihet llog 644 " Sigurimet shoqerore dhe shendetësore".

**Shpenzimet financiare ne vleren 2,010,085 leke përfshijnë:**

Llogaria 628 "Sherbime bankare", llogaria 667 " Shpenzime per interesa", llogaria 669 "Humbje nga kembimet valutore".

### **MBI TË ARDHURAT**

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën **46,142,917 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit ku perfshihet:

**Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit ne vleren 50,881,097 leke nga llogaria 704 " Shitje e punimeve dhe e sherbimeve", llogaria 705 "Shitje mallra", 7081 "Qera".**

### **PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT**

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	2,354,287
SHPENZIME TE PANJOHURA	210,970
TATIM FITIMI (15%).	384,789
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	1,969,498

### **PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte**

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim **46,994 lekë**

Mjete monetare ne fund te periudhes **922,174** lekë

Rritja/rrenja neto e mjeteve monetare **875,180** lekë

Pra,ka perputhje te plote te pasqyres te fluksit monetar dhe gjendjes te aktiveve monetare te vendosura ne aktiv te bilancit.

### PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej **5,902,251** lekë cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2020.

### SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime,nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2020.

Tiranë , më 30.03.2021

Ekonomisti

*Migjen Marku*



Administratori

Gjergji Kerpi